

VENDIM
Nr. 488, datë 14.6.2013

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR. 502, DATË 13.7.2011 TË KËSHILLIT
TË MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E RREGULLORES UNIFORME TË KONTROLLIT TË
ZHVILLIMIT TË TERRITORIT”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të ligjit nr. 10 119, datë 23.4.2009 “Për planifikimin e territorit”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në shtojcën 1 të rregullores uniforme të kontrollit të zhvillimit të territorit, miratuar me vendimin nr. 502, datë 13.7.2011 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

a) Në shkronjën “c” të pikës 2 të nenit 6, fjalët “...të paktën 50% të sipërfaqes së ndërtuar mbi tokë...” zëvendësohen me “...të paktën 30% të sipërfaqes së ndërtuar mbi tokë...”.

b) Pas pikës 3 të nenit 13, shtohet paragrafi, me këtë përmbajtje:

“Kur projekti i zhvillimit, subjekt i pajisjes me leje infrastrukture, i paraqitur nga institucione shtetërore ose subjekte private për qëllime të ofrimit të shërbimeve publike, parashikohet të krijojë servitute në pronë, në administrim të institucioneve të tjera shtetërore, aplikuesi, përmes një deklarate, merr përsipër zhdëmtime të mundshme që vijnë si rezultat i zhvillimit të ri dhe kthimin e truallit në gjendjen e mëparshme para fillimit të zhvillimit. Në rast se pronë kur krijohet servituti është pronë private, aplikuesi paraqet marrëveshjen për krijimin e servitutit me pronarin e truallit.”.

c) Në fund të pikës 1 të nenit 15 “Këshilli teknik”, shtohet paragrafi me këtë përmbajtje:

““Këshilli teknik” funksionon në përputhje me ligjin nr. 8480, datë 27.5.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale”.”.

2. Ngarkohen autoritetet e planifikimit, të përcaktuara në nenet 5 e 12 të ligjit nr. 10 119, datë 23.4.2009 “Për planifikimin e territorit”, të ndryshuar, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha